

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të dorëzuar nga shoqëria GENERALI SCF S.a.r.l. me seli ne Bulevardin F.V. Rajfajzen nr. 15, Luksemburg, Principata e madhe e Luksemburgut dhe Shoqëria Komandite KURA Fermungensfervaltung G.m.b.H. & Ko me seli në Zaseller Dam 39 a, 22395 Hamburg, Gjermani, dorëzuar përmes Martin Ivanov, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 25.11.2022, solli

AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga GENERALI SCF S.a.r.l. me seli ne Bulevardin F.V. Rajfajzen nr. 15, Luksemburg, Principata e madhe e Luksemburgut dhe Shoqëria Komandite KURA Fermungensfervaltung G.m.b.H. & Ko me seli në Zaseller Dam 39 a, 22395 Hamburg, Gjermani, mbi shoqërinë T-C PEP Properti S.a.r.l. me seli ne rrugen Hildegard Fon Bingen nr. 1, Luksemburg, Principata e Madhe, Luksemburg, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve, , edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tariferor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 25.10.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar njoftim i përqendrimit nga GENERALI SCF S.a.r.l. me seli ne Bulevardin F.V. Rajfajzen nr. 15, Luksemburg, Principata e madhe e Luksemburgut dhe Shoqëria Komandite KURA Fermungensfervaltung G.m.b.H. & Ko me seli në Zaseller Dam 39 a, 22395 Hamburg, Gjermani, me të cilin GENERALI SCF S.a.r.l. nga Principata e Madhe e Luksemburgut dhe shoqëria komandite KURA Fermungensfervaltung G.m.b.H. & Ko nga Gjermania do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë T-C PEP Properti S.a.r.l. me seli ne rrugen Hildegard Fon Bingen nr. 1, Luksemburg, Principata e Madhe e Luksemburgut, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

- **GENERALI SFC S.a.r.l.** është një subjekt i lidhur me Asikuracioni Generali S.p.a., një shoqëri aksionare e krijuar sipas ligjeve të Italisë. Grupi Generali tani është i pranishëm në mbi 60 vende të botës dhe është aktiv në sektorin e sigurimeve dhe atë financiar. Grupi Generali aktualisht operon kryesisht në Evropën Perëndimore dhe në vendet kryesore të Evropës Qendrore dhe Lindore. Jashtë BE-së, ajo është gjithashtu aktive në Zvicër, Brazil dhe Argjentinë, Kinë dhe vende të caktuara në Lindjen e Largët. GENERALI SFC S.a.r.l. është ndërmarrje-bijë në pronësi të plotë të Generali Shopping Center Fond S.C.S. (GShCF) i cili është një fond investimi me fokus të veçantë në investimin dhe menaxhimin e qendrave tregtare në sektorin e shitjes me pakicë të Evropës kontinentale.

GENERALI SFC S.a.r.l. është prezentë në Maqedoninë e Veriut përmes **Shoqërisë për menaxhimin e fondeve të hapura dhe të mbyllura investive GENERALI INVESTEMNTS SHA Shkup** me seli në adresën bul. Partizanski Odredi nr. 14A-1/2 Shkup dhe me aktivitet të regjistruar - Veprimtaritë e menaxhimit të fondeve. Shoqëria GENERALI INVESTEMNTS SHA Shkup shërben një gamë të gjerë të fondeve institucionale dhe me portofol diskrecional.

- **Shoqëria Komandite KURA Fermungensverwaltung G.m.b.H. & Ko** është aksionari i vetëm i Grupit ECE. ECE është aktive në shërbimet e konsulencës dhe agjencisë në lidhje me blerjen, zhvillimin, planifikimin dhe ndërtimin e pronave komerciale dhe pasurive të tjera të paluajtshme, si dhe dhënien me qira, administrimin, menaxhimin dhe shitjen e pronave të tilla. Fokusi i aktiviteteve të ECE është në pronat e paluajtshme në sektorët komercial, zyra, transport, hoteleri, ndërtesa dhe industri.

- **C PEP Properti S.a.r.l.** zotëron pasuri të paluajtshme në Muni, Gjermani. Në pasuritë e paluajtshme gjendet një qendër tregtare e njohur si PEP Ajnkaufscenter Nojperlah me adresë në rrugën Tomas-Deller-Shtrase 8, 10, 12, Fon-Knoeringen Shtrase 1 dhe Ollenhauersshtrase 6, Muni, Gjermani.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски